

**STATUTI**  
**I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**  
**" V & T " SHPK**

Ne Tirane sot me date 28 / 09 / 2018(dymijecetetembedhjete) , ne mbeshetje te Ligjit Nr. 9901 , date 14/04/2008 " Per shoqerite Tregtare " , neni 230 , pika 2 " Vijimi i funksionimit dhe detyrimi per pershtatje " , te Ligjit Nr. 7850 , date 29/07\*1994 " Per Kodin Civil te Republikes se Shqiperise , ligjit Ne. 9723 date 03.05.2007 " Per Qendren kombetare te Regjistrimit " ne :

- 1- Z. Dorjan Leknikaj I biri i Istrefit \_i dtl 07.07.1970 , lindur ne Shkoder , dhe banues ne Tirane , madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar , me document identifikues ID H00707052W
- 2- Zj. Roberta Martinaj e bija i Koles i dtl 30.03.1991 , lindur ne Lezhe , dhe banuese ne Tirane , madhore dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar , me dokument identifikues ID J15330065I

Me vullnetim tone te plote vendosem pershtatjen e Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar "V & T " SHPK , me cilesine e ortakut te vetem dhe themelues duke percaktuar te drejta dhe detyrime ne kete statut si me poshte :

**KAPITULLI I**  
**FORMA , EMERTIMI , OBJEKTI , SELIA , KOHEZGJATJA**  
**NENI 1**  
**Forma**

- 1.1 Shoqeria "V & T " SHPK ( ne vijim shoqeria ) krijohet ne formen e nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar , dhe veprimtaria e saj rregullohet me ane te ketij Statuti .
- 1.2 Shoqeria vepron sipas Ligjit Nr. 9901 date 14/04/2008 " Per Shoqerite tregtare " ,ligji Nr. 7850 date 29/07/1994 " Per Kodin Civil te Republikes se Shqiperise " si dhe githe legjislacionit Shqiptar ne Fuqi .
- 1.3 Statuti eshte ne perputhje me legjislacionin shqiptar qe ka karakter te detyrueshem , ndersa ceshtjet qe nuk jane shprehim,isht te parashikuara ne to , plotesohen nga legjislacioni shqiptar .



## NENI 2

### Emertimi

2.1 Emertimi i Shoqerise eshte "V & T" SHPK

2.2 Shoqeria ka vulen dhe logon e saj identifikuese , ne formen dhe me ekstremitetet e caktuara nga ortaku i vetem .

## NENI 3

### Objekti i veprimtarise se shoqerise

3.1 Objekti i veprimtarise se Shoqerise "V & T" SHPK eshte ne perputhje me legjislacionin tregetar actual Shqiptar dhe do te jete : Bulevardi Bajram Curri , Qendra ETC , kati 12

- IMPORT & EXPORT & TREGETIM KAFEJE DHE NENPRODUKTEVE TE SAJ ,  
IMPORT & EXPORT & TREGETIM I PRODUKTEVE USHQIMORE

3.2 Per te realizuar objektin e saj , shoqeria mund te kryeje cdo operacion tregetar , operac:one qe lidhen me blerje te pasurive te luajtshme dhe te paluajtshme , financiare , dhe kreditimi ashtu si dhe administrimi , si dhe te bleje dhe te shese ose marre me qera ndermarje , dege ndermarrjesh , si dhe te kete interesa dhe pjesemarrje ne shoqeri me konsociume , te themeluara apo ne themelim e siper , qe kane objekt te njejte ose te ngjashem me te vetin apo gjithesesi funksional per arritjen e qellimeve te shoqerise . Me ne pergjithesi shoqeria mund te kryeje cdo aktivitete tjeter te nevojshem apo te dobishem per realizimin e qellimeve te shoqerise .

3.3 Objekti i shoqerise mund te ndryshohet dhe / ose shtohet me vendim te Asamblese se Pergjithshme te Aksionereve .

3.4 Shoqeria mund te ushtroje veprimtari te tjera plotesuese qe jane te dobishme ose te nevojshme per realizimin e objektit te saj ne perputhje ,e ligjin shqiptar .

3.5 Shoqeria do te bashkepunoje me persona te tjeter fizike ose juridike qe ushtrojne te njejten veprimtari ne Shqiperi ose jashte saj .

## NENI 4

### Selia

4.1 Selia e shoqerise eshte ne adresen : Bulevardi Bajram Curri , Qendra ETC , kati 12,  
Tirane



4.2 Transferimi i selise se Shoqerise ne nje vend tjetër behet me vendim te Asamblese se Pergjitheshme .

4.3 Asambleja e Pergjitheshme mund te vendose hapjen e filialeve , degeve dhe perfaqesive te Shoqerise ne qytete te tjera te Shqiperise se dhe jashte saj .

## NENI 5

### Kohezgjatja e Veprimtarise

5.1 Kohezgjatja e shoqerise "V & T " SHPK eshte e pakufizuar dhe fillon ne momentin e Regjistrimit ne Qendren Kombetare te Regjistrimit sipas ligjit Nr.9723 date 03.05.2007 nenet 26,28,32 dhe 35 te tij pershtatur me Ligjin Nr,9901 date 14.04.2008 " Per Tregetaret dhe Shoqerite Tregetare " , neni 230 , pika 2 , " Vijimi i funksionit dhe detyrimi per pershtatje "

5.2 Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar "V & T " SHPK priset :

5.2.1 Me vendim te Asamblese se Pergjitheshme

5.2.2 Me hapjen e procedurave te falimentimit

5.2.3 Nese nuk ka kryer veprimtari tregetare per dy vjet dhe nuk eshet njoftuar pezullimi i veprimtarise ne perputhje me puken 3 te bnenit 43 te ligjit 9723 date 03.05.2007 " per Qendren Kombetare te Regjistrimit "

5.2.4 Me vendim te gjykates

5.2.5 Per arsye te tjera te parashikuara ne statut

## KAPITULLI II

### KAPITALI THEMELTAR ,KONTRIBUTET ,NDARJA E PEJESEVE TE KAPITALIT

## NENI 6

### Kapitali themeltar

6.1 Kapitali themeltar i shoqerise "V & T " SHPK eshte 100.000,00(njeqind mije lek )

6.2 Kapitali themeltar i shoqerise perbehet nga 100.000 leke , i ndare ne 2 kuota dhe zoteroret 50 % nga Ortaku z. Dorjan Leknikaj dhe 50 % nga Ortakja zj. Roberta Martinaj .

## NENI 7

### Kontributet

7.1 Sipas kontributeve te mesiperme :



7.2 Z. DORJAN LEKNIKAJ eshte mbajtes i 50 % te kuotave te kapitalit themeltar dhe ZJ .ROBERTA MARTINAJ eshte mbajtese e 50% te kuotave te kapitalit themeltar , qe perbejne 2 kuota me vlere nominale 50.000,00 ( pesedhjetemije )leke secila .

## NENI 8

### Rritja e kapitalit themeltar

8.1 Kapitali themeltar mund te rritet pa kufi ne cdo moment me vendim te Asamblese se Pergjitheshme .

8.2 Ne rast rritjeje te kapitalit ,ortaku ka te drejte te nenshkruaje rritjen ne raport me pjeset e kapitalit te zoteruara prej tij .

## NENI 9

### Zvogelimi i kapitalit themeltar

9.1 Shoqeria mund te zvogeloje kapitalin themeltar me vendim te Asamblese se Pergjitheshme . Ne cdo rast kapitali themeltar nuk mund te zvogelohet nen kufijte e parashikuar nga ligji .

9.2 Zvogelimi i kapitalit perballohet nga ortaku ne te njejten mase me pjeset e kapitalit te zoteruara prej tij .

## NENI 10

### Transferimi i pjeseve te kapitalit dhe e drejta e parablerjes

10.1 Pjeset e kapitalit jane lirisht te transferueshme nga ortaku tek persona fizik apo persona juridik te tjere .

10.2 Ne nejt rast te tille ortaku qe do te transferoje pjeset e tij te kapitalit duhet ti njoftoje ortaket e tjere nese do te kete shoqeria , me leter rekomande me konfirmim marrje ne dorezim , mbi synimin per shitjen , cmimin , kushtet , modalitete, emrin e blesesit dhe afatet e transferimit . E drejta e parablerjes i referohet te gjitha pjeseve te kapitalit et ofruar per shitje .

10.3 Ortaket nese do te kete shoqeria , do te kene ne dispozicion 15 dite nga marrja e letres rekomande me konfirmim marrje ne dorezim , per ti komunikuar ortakut qe transferon pjeset e kapitalit , synimin e tyre per te ushtruar apo jo te drejten e parablerjes . Ne rast se ata nuk pergjigjen ne afatin e caktuar , prezumohet se kane hequr dore nga e drejta e tyre e parablerjes .



10.4 Ne rast se oferta pranohet nga disa ortakë nëse do të ketë shoqëria , pjesët e kapitalit të ofruara nga ortakët që transferon pjesët e kapitalit , do të ndahet nga ortakët pranues , në mënyrë proporcionale me pjesët që ata zotërojnë , përveç rasteve kur ka një marrëveshje të ndryshme ndërmjet palëve . Në asnjë rast , pranuesi i ofertës nuk mund të ushtrojë pjesërisht të drejtën e parablerjes.

10.5 Në rast se nuk ushtrohet e drejta e parablerjes , pjesët e kapitalit mund të transferohen të tërëta plotësisht apo pjesërisht .

10.6 Në rast të transferimit të pjesëve të kapitalit për shkak të trashëgimitë kuotat do të rregjistrohen në bazë të nenit 43 të ligjit Nr. 9723 datë 03.05.2007 “ Për Qendrën Kombëtare të Rregjistrimit ” .

### KAPITULLI III

#### ASAMBLEJA , ADMINISTRATORET DHE EKSPERTI KONTABEL

##### NENI 11

#### Asambleja e Përgjithshme dhe kompetencat e saj

11.1 Organi vendim – marrës i shoqërisë është Asambleja e Përgjithshme

11.2 Asambleja e përgjithshme e shoqërisë është përgjegjëse për marrjen e vendimeve të mëposhtme :

11.2.1 Përcaktimin e politikave tregëtare të shoqërisë

11.2.2 Ndryshimin e Statutit

11.2.3 Emerimin dhe shkarkimin e administratorëve

11.2.4 Emerimin dhe shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabel të autorizuar

11.2.5 Përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në nenet 11.2.3 dhe 11.2.4 të këtij neni


11.2.6 Mbikqyrjen dhe zbatimin e politikave tregëtare nga administratorët , përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë

11.2.7 Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë

11.2.8 Zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit

11.2.9 Pjestimin e kuotave dhe anulimin e tyre

11.2.10 Përfaqesimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve



11.2.11 Riorganizimin dhe prishjen e shoqerise

11.2.12 Miratimin e rregulave procedurale te mbledhjeve te asamblese

11.2.13 Ceshtje te tjera te parashikuara nga ligji apo statuti

11.2.14 Asambleja e pergjitheshme merr vendime per ceshtjet e percaktuara ne nenet 11.2.7 dhe 11.2.8 te ketij statuti pas marrjes dhe shqyrtimit te dokumentave perkates

## NENI 12

### Thirrja e Asamblese se Pergjitheshme

12.1 Asambleja e Pergjitheshme mblidhet ne rastet e percaktuara nga ligji Nr.9901 date 14.04.2008 " Per Tregetarët dhe Shoqerite Tregtare dhe sa here qe mbledhja eshte e nevojshme per te mbrojtur interesat e shoqerise . Mbledhja e zakonshme e asamblese se pergjitheshme thirret te pakten nje here ne vit .

11.2 Asambleja e Pergjitheshme thirret nga administratoret apo ortakët e percaktuar sipas ligjit Nr.9901 date 14.04.2008 " Per Tregetarët dhe shoqerite Tregtare " neni 84 .

12.3 Asambleja e Pergjitheshme thirret nese sipas bilancit vjetor apo raporteve financiare rezulton ose oksiston rreziku qe aktivet e shoqerise nuk mbulojne detyrimet e kerkueshme brenda 3- muajve ne vazhdim

12.4 Asambleja e Pergjitheshme thirret kur shoqeria propozon te shese apo te disponoje ne menyre tjeter aktive , te cilat kane nje vlere me te larte se 5 % te asetëve te shoqerise qe rezulton ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara

12.5 Asambleja e Pergjitheshme thirret kur shoqeria brenda dy viteve te para pas rregjistrimit te saj propozon te bleje nga nje ortak pasuri , qe kane vlere me te laret se 5 % te asetëve te shoqerise , qe rezulton ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara

12.6 Asamblese se Pergjitheshme per rastet e parashikuar ne nenet 13.3 dhe 13.5 te statutit i paraqitet nje raport nga nje eksperti kontabel o autorizuar i pavaruar . Dispozitat e neneve 13.3 dhe 13.5 te ketij statuti nuk zbatohen nese blerjet sipas keture parashikimeve kryhen ne burse , ose jane pjese e veprimeve te perditeshme te shoqerise dhe behen ne kushte normale tregu

12.7 Vendimet e Asamblese se Pergjitheshme duhet te nenshkruhen nga Kryetari i Asamblese dhe nga Sekretari

## NENI 13

### Menyra e thirrjese se Asamblese



13.1 Asambleja e pergjitheshme thirret nepermjet nje njoftimi me shkrese ose me njoftim nepermjet postes elektronike . Njoftimi me shkrese ose apo me mesazh elektronik duhet te permbaje vendin , daten , oren e mbledhjes dhe rendin e dites e tu dergohet te gjithe ortakeve jo me vonë se 7 dite perpara dates se parashikuar per mbledhjen e asambese .

13.2 Kur asambleja e pergjitheshme nuk eshet thirrur sipas parashikimeve te nenit 14.1 te ketij statuti , ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem nese te gjithe ortaket nese ka shoqeria , jane dakort per te marre vendime pavaresisht parregullsise . Nese shoqeria nuk ka ortake ajo merr vendime sipas parashikimeve te mesiperme .

## NENI 14

### **Kerkesa nga ortaket e pakices per te thirrur asamblene**

14.1 Ortaket nese do et kete shoqeria te cilet perfaqesojne te pakten 5 % te totalit te votave ne asamblene e pergjitheshme , apo nje pjese me te vogel te parashikuar ne statut , mund ti drejtojen administratoreve nje kerkese me shkrim , perfshire posten elektronike per te thirrur asamblene e pergjitheshme dhe / ose perfshirjen e ceshtjeve te posacme ne rendin e dites .Kerkesa duhet te permbaje arsyet , objektivat dhe ceshtjet per te cilat asambleja duhet te marre nje vendim . Nese kerkesa refuzohet , keta ortake kane te drejte te therrasin asamblene dhe te caktojne ceshtjet e rendit te dites , ne perputhje me parashikimet e nenit 14.1 te ketij statuti.

14.2 Nese ne kundershtrim me nenin 14.5 te ketij statuti asambleja e pergjitheshme nuk thirret , ose ceshtja e kerkuar prej ketyre nuk futet ne rendin e dites , secili prej ortakeve nese do te kete shoqeria , qe kane bere kerkesen ka te drejte te :

14.2.1 Te ngreje padi ne gjykate per te deklaruar shkeljen e detyrimit te besnikerise , nese administratoret nuk permbushin kerkesat e ortakeve brenda 15 diteve .

14.2.2 Ti kerkoje shoqerise blerjen e kuotave te zoteruara prej tyre .

14.3 Ne rast kur rendi i dites ndryshohet , sipas parashikimeve te neneve 15.1, 15.2 15.2.1 15.2.2 te ketij statuti dhe thirrja i eshte njoftuar ortakut te vetem , administratoret njoftojne perseri rendin e dites te ndryshuar ne perputhje me parashikimet e nenit 14.1 te ketij statuti .

14.4 Perfaqesuesi i autorizuar eshet i detyruar te deklarroje cdo fakt apo rrethane te tille qe sipas gjykimit te oratkut te perfaqesuar , rrezikon te ndikojne ne vendimarrjen e perfaqesuesit per interesa te tjere te ndryshem nga ata te ortakut te perfaqesuar .

## NENI 15

### **Perfaqesimi i Asamblese**



15.1 Ortaku mund te perfaqesohet ne asamlene e pergjitheshme , ne baze te nje autorizimi nga nje ortak tjetër apo nga nje person i tretë .

15.2 Administratoret e shoqerise nuk mund te veprojnë si perfaqesues te ortakeve ne asamble .

15.3 Autorizimi mund te jepet vetem per nj mbledhje te asamblese , e cila perfshin dhe mbledhjen vijuese me te njejtin rend dite .

## NENI 16

### Kuorumi per marrjen e vendimeve

16.1 Ne rastin e marrjes se vendimeve qe kerkojen nje shumice te zakonshme asambleja e pergjitheshme mund te marre vendime te vlefshme vetem nese marrin pjese ortaket me te drejte vote , qe zoterojne me shume se 30% te kuotave . Ne rastin kur asambleja duhet te vendse per ceshtje te cilat kerkojne shumice te kualifikuar sipas ligjit Nr.9901 dt 14.04.2008 " Per Tregetaret dhe Shoqerite Tregetare " neni 87 , ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem nese ortaket qe zoterojne me shume se gjysma e numrit total te votave jane te pranishem personalisht , votojne me shkrese , apo mjete elektronike , sipas parashikimeve te ligjit Nr.9901 dt 14.04.2008 " Per Tregetaret dhe Shoqerite Tregetare " , neni 88 pika 3.

16.2 Nese asambleja e pergjitheshme nuk mund te mblidhet per shkak te mungeses se kuorumit te permendur ne nenin 17.12 te ketij statuti , nese shoqeria do te kete ortake , asambleja mblidhet perseri jo me vone se 30 dite , me te njejtin rend dite .

## NENI 17

### Marrja e Vendimeve nga Asambleja e Pergjitheshme

17.1 Me perjashtim te rasteve kur statuti parashikon nje shumice me te larte , asambleja vendos  $\frac{3}{4}$  e votave te ortakeve pejsmarres nese ka , sic parashikohet ne nenin 86 pika 1 ligji Nr.9901 dt14.04.2008 " Per Tregetaret dhe Shoqerite Tregetare " , per ndryshimin e statutit , zmadhimin apo zvogelimin e kapitalit te regjistruar , shperndarjen e fitimeve , riorganizimin dhe prishjen e shoqerise .

17.2 Me perjashtim te rasteve kur parashikohet ndryshe ne ligj ose ne statut per ceshtjet e tjera te parashikuara ne nenin 81 te ligjit Nr.9901 dt 14.04.2008 " Per Tregetaret dhe Shoqerite Tregetare " , asambleja vendos me shumicen e votave te ortakeve pjesmarres .

17.3 Me perjashtim te rasteve kur parashikohet ndryshe ne ligj , vlefshmeria e vendimeve qe percaktojne shtese mbi ortaket , apo vendimet qe kufizojne te drejtat e tyre , te parashikuara ligjin Nr.9901 dt14.04.2008 " Per Tregetaret dhe Shoqerite Tregetare " , ose ne statut , kushtezohet nga miratimi i ortakut perkates .





## NENI 18

### E Drejta e Votes

18.1 Me perjashtim te rasteve kur parashikohet ndryshe ne statut , cdo kuote jep te drejten e nje vote

18.2 Ortaket nese do te kete , qe nuk jane te pranishem ne mbledhej kane te drejte te marin pjese me mjete te ndryshme komunikimi perfshire mjetet elektronike me ksht qe te garantchet identifikimi i ortakut

18.3 Mjetet elektronike perfshijen por pa u kufizuar ne to :

18.3.1 Trasmetimin e mbledhjes ne kohe reale

18.3.2 Komunikim te ndersjellte ne kohe reale i cili u mundeson ortakeve te shprehen per mbledhjen nga ne vendoshje tjeter

18.3.3 Mekanizma , qe mundesjne procesin e votimit perpaar apo gjate mbledhejs se asamblese se pergjitheshme pa qene nevoja te caktohet nje perfaqesues i autorizuar , per te marre pjese fizikisht ne mbledhje

18.4 Ortaku i vetem ka te drejkten qe i njihet nga ligji Nr.9901 dt14.04.2008 “ Per Tregetaret dhe Shoqerite Tregetare “, apo statuti i shoqerise , per te marre unanimisht cdo vendim , me kusht qe kjo marreveshje te behet me shkrim .

## NENI 19

### Perjashtimi nga e drejta e Votes

19.1 Ortaku nuk mund et ushtroje te drejten e votes nese asambleja merr vendim per :

19.1.1 Vleresimin e veprimtarise se tij

19.1.2 Shuarjen e ndonje detyrimi ne ngarkim te tij

19.1.3 Ngritje e nje padije ndaj tij nga shoqeria

19.1.4 Dhenien ose jo te perfitimeve te reja

19.2 Kur ortaku perfaqesohet nga nje perfaqesues i autorizuar , i autorizuari vleresohet et jete ne te njejtin konflikt interesi , ashtu si dhe ortaku te cilin perfaqeson .



## NENI 20

### Proces –Verbali i Mbledhjes se Asamblese

- 20.1 Vendimet e Asamblese se pergjitheshme duhet te regjistrohen ne proces verbal  
Administratoret pergjigjen per ruajtjen e kopjeve te proces verbaleve te mbledhjeve
- 20.2 Prosec verbali duhet te permbaje daten , vendin e mbledhejs , rendin e dites , emrin e kryetarit te mbajtesit te proces verbalit , rezultatin e votimit .
- 20.3 Prosec verbalit i bashklidhet lista e pjesmarresve , si dhe akti i thirrjes se asamblese
- 20.4 Proces verbali nenshkruhet nga kryetari dhe nga mbajtesi i proces verbalit

## NENI 21

### Administratoret

- 21.1 Asambleja e Pergjitheshme emerone nje ose me shume persona fizik si administratore te shoqerise .
- 21.2 Administrator i shoqerise “V & T “ SHPK emerohet **Z. DORJAN LEKNIKAJ** i biri i Istrefit i dtl 07.07.1970 - me dokument identifikimi **ID H00707052W** , me afat 5 vjecar me te drejte riperteritje .
- 21.3 Administratoret kane te drejte te detyrohen :
- 21.3.1 Te kryejne te gjitha veprimet e administrimit te veprimtarise tregetare te shoqerise , duke zbatuar politikat tregetare nga asambleja e pergjitheshme
- 21.3.2 Te perfaqesoje shoqerine tregetare
- 21.3.3 Te kujdesen per mbajtjen sakte dhe te rregullt te dokumentacionit dhe librave kontabel te shoqerise
- 21.3.4 Te pergatisin dhe te neshkruajne bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise se veprimtarise dhe se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve , i paraqesin keto dokumente perpara asamblese
- 21.3.5 Te krijojne nje sistem paralajerimi ne kohen e duhur per rrethanat qe kercenojnen mbarevajtjen e veprimtarise



21.3.6 Te kryejne dhe te dergojne te dhenat e detyrueshme te shoqerise sic parashikohet ne ligjin per Qendren Kombetare te Regjistrimit

21.3.7 Te raportoje para asamblese per zbatimin e politikave tregetare dhe realizimin e veprimtarive te posacme me rendesi te vecante per veprimtarine e shoqerise tregetare .

21.3.8 Administratori mund te emeruje perfaqesues te posacem per veprime apo kategori te caktuara veprimesh

21.4 Asambleja epergjithshme mund te shkarkoje administratorin ne cdo koeh me shumice te zakonshme . statuti apo marrveshje te tjera nuk mund ta kufizojne kete te drejte .

## NENI 22

### Perfaqesimi

22.1 Shoqerite Tregetare perfaqesohen sipas rregullave te caktuara nga ligji Nr.9901 dt14.04.2008 “ Per Tregetaret dhe Shoqerite Tregetare “ dhe te dispozitave te ketij statuti .

Perfaqesimi ligjor i shoqerise eshte i vlefshem per cdo veprim gjyqesor apo jogjyqesor

22.2 Tagrat e perfaqesimit te administratoreve dhe ne cdo ndryshim i tyre njoftohen per regjistrim prane Qendres Kombetare te Rregjistrimit .

## NENI 23

### Prishja e Shoqerise

23.1 Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar priset :

23.1.1 Kur mbaron kohezgjatja e parashikuar ne themelin e saj

23.1.2 Me vendim te asamblese se pergjitheshme

23.1.3 Me hapjen e procedurave te falimentimit

23.1.4 Nese nuk ka kryer veprimtari tregetare per dy vjet dhe nuk eshte njoftuar pezullimi ne perputhje me ligjin Nr.9723 dt23.05.2007 “ Per Qendren Kombetare te Rregjistrimit “ neni 43 , pika 3.

23.1.5 Me Vendim te Gjykates

23.1.6 Per arsye te tjera te parashikuara ne statut

## NENI 24



## **Rregjistrimi i Shperndarjes**

24.1 Administratoret rregjistroren prishjen e shoqerise prane Qendres Kombetare te Rregjistrimit ne perputhje me ligjin Nr.9723 dt23.05.2007 " Per Qendren Kombetare te Rregjistrimit " neni 43 .

24.2 Nese prishja e shoqerise behet me vendim gjykate , gjykata ne perputhje me ligjin Nr.9723 dt23.05.2007 " Per Qendren Kombetare te Rregjistrimit " neni 45, ia njofton vendimin Qendres Kombetare te Rregjistrimit

### **NENI 25**

#### **Largimi i Ortakut per shkaqe te arsyeshme**

25.1 Ortaku mund te largohet nga shoqeria nese ortaket e tjere nese ka ose shoqeria ka kryer veprime ne dem te tij , nese eshet penguar te ushtroj te drejtat e tij , nese shoqeria i ka ngarkuar detyrime te pa arsyeshme apo per shkaqe te tjera , qe e bejne te pamundur vazhdimin e ortakerise .

25.2 Ortaku nese shoqeria eshet me disa ortake , qe kerkon largimin , duket te njoftoje shoqerine me shkrim , si dhe te parashtroje shkaqet e largimit .

25.3 Administratoret duhet te therrasin mbledhjen e asamblese menjehere pasi te kene marre dijeni per njoftimin e largimit , siaps parashikimeve te nenit 26.2 te statutit , per te vendosur nese ortakut do ti likujdohet kuota , si pasoje e largimit per shkaqe te arsyeshme .

25.4 Ortaku qe kerkon largimin nga shoqeria , s etyrohet ta demshperbleje shoqerine per demet e shkaktuara , nese rezulton se largimi eshte kryer ne baze te shkaqeve te paarsyeshme

### **NENI 26**

#### **Perjashtimi i Ortkut**

26.1 Asambleja ne baze te nje vendimi te zakonshem mund ti kerkoje gjykates perjashtimin e ortakut nese shoqeria eshte me disa ortake , nese ai nuk ka shlyer kontributin e tij , sipas parashikimeve te statutit ose nese egzistojne shkaqe te tjera te arsyeshme per kete perjashtim

26.2 Do te konsiderohen shkaqe te arsyeshme per perjashtimin e ortakut por pa u kufizuar ne keto rastet kur ortakut :

26.2.1 Me dashje apo nga pakujdesia i shkakton deme te renda shoqerise dhe ortakeve

26.2.2 Me dashje apo nga pakujdesia shkel statutin ose detyrimet e percaktuara me logj



26.2.3 Përfshihet në veprime të cilat bëjnë të pamundur vazhdimin e marrëdhënieve midis shoqërisë tregëtare dhe ortakut

26.2.4 Me veprimet e tij demton ose pengon ndjeshëm veprimtarinë tregëtare të shoqërisë

## NENI 27

### **Eksperti kontabel i autorizuar**

27.1 Eksperti Kontabel i Autorizuar emërohet nga asambleja e Përgjithshme ose me Vendim Gjykatë për kontrollin e bilancëve, librave kontabel të Shoqërisë etj

27.2 Eksperti Kontabel i Autorizuar mund të shkarkohet në çdo moment sipas menyrave të parashikuara nga legjislacioni në fuqi

## KAPITULLI IV

### **VITI FINANCIAR, BILANCI VJETOR, SHPËRNDARJA E FITIMEVE**

## NENI 28

### **Viti Financiar dhe bilanci vjetor**

28.1 Ushtrimi financiar fillon më 1 Janar dhe mbaron më 31 Dhjetor të çdo viti

28.2 Viti i parë financiar fillon në datën e regjistrimit të Shoqërisë në Qendren Kombëtare të Regjistrimit dhe përfundon në 31 Dhjetor të të njëjtit vit .

28.3 Bilancet vjetore, inventari, raportet e administratorit dhe të tjerat janë të nevojshme të ekspertit kontabel të autorizuar miratohen nga Asambleja e Përgjithshme

28.4 Miratimi i dokumentave që lidhen me vitin financiar duhet të bëhet brenda 6 muajve që nga fundi i vitit financiar .

## NENI 29

### **Fitimet**

29.1 Fitimet që rezultojnë nga bilanci vjetor, duke zbritur 5% që caktohen për rezervën Ligjore deri në 10 % e kapitalit themeltar, dhe duhet zbritur gjithashtu të gjitha shumat që Asambleja vendos të vë në dispozicion të shoqërisë, u shpërndahen ortakëve në proporcion me pjesët e kapitalit themeltar të zotëruara respektivisht .



29.2 Asambleja e Pergjitheshme mund te vendose edhe zbritje te vecanta ne favor et rezervave te jashtezakonshme ose per qellime te tjera apo dhe shtyrjen e shperndarjes se fitimeve , plotesisht ose pjeserisht per vitet financiare te ardhshme

## **NENI 30**

### **Likuidimi**

30.1 Ne rast prishjeje , Shoqeria do te likujdohet .

30.2 Per te administruar kete procedure , Asambleja emeron nje ose disa likuidatore , te cilet paraqesin raportet perfundimtare mbi gjendjen e aktivitet dhe pasivit te Shoqerise , mbi operacionet e likujdimit dhe mbi kohen per te perfunduar likujdimin .

30.3 Me perfundimin e procedurave te likujdimit Asambleja do et vendose mbi bilancin financiar perfundimtare, mbi vlefshmerine e punes se kryer nga likjduesit dhe mbi perfundimin e procesit et likujdimit .

30.4 Pas pgimit te kreditoreve dhe mbledhjes se kredive , likuidatori do ti shperndaje te ardhurat perfundimtare te likujdimit ortakut apo ortakeve ne propocion me pjeset e kapitalit te zoteruara prej tyre ne kapitalin themeitar.

## **NENI 31**

### **Dispozita te Pergjitheshme**

31.1 Per ceshtjet qe nuk parashikohen ne kete statut zbatohen dispozitat e ligjit Nr 9901 date 14.04.2008 “ Per Tregetaret dhe shoqerite Tregetare “ .

31.2 Ky statut u hartua ne 4 (kater ) kopje ne gjuhen shqipe dhe pasi u lexua nga ortaku i vetem i shoqerise u nenshkrua prej tij vullnetarisht .

## **ORTAKET E SHOQERISE**

**DORJAN LEKNIKAJ**

DORJAN LEKNIKAJ



**ROBERTA MARTINAJ**

